



Instituti i Kërkimeve Urbane

FLETË INFORMUESE MBI PROJEKTET

Instituti i Kërkimeve Urbane

Ndërgjegjësimi dhe Këshillimi ligjor për regjistrimin e pasurive në rrethin e Pogradecit

Forcimi i zbatimit të ligjit.

Konteksti

Rrethi I Pogradecit ka një popullsi prej afro 70 000 banorësh. Megjithatë rreth 60% e pasurive janë regjistruar procesi i regjistrimit fillestar nuk ka përfunduar vecanerisht në zona me vlerë të lartë sic janë komunat Bucimas, Hudenisht, Cerrave etj. përfshirë këtu edhe pronat e transferuara në pronësi të njesive vendore. Disa prej pasurive akoma të përgjithshme të familjeve shumë të varfra ose kanë komplikime dokumentare që e bëjnë të vështirë për këta njerëz që të qasen në ZRPP vendore. Projekti do të rrisë kapacitetet e ZRPP, ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe do të sigurojë asistencë teknike dhe ligjore si dhe do të ndërtojë linjat e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të ZRPP me qytetarët dhe grupet e tjera të interesit.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i projektit synon që të sigurojë asistencë ligjore dhe teknike për qytetarët në mënyrë që ata të ushtrorin të drejtat e tyre mbi pronat duke regjistruar pasuritë, sigurimin e titujve të pronësive dhe përdorimin e tyre.

Objektivat Kryesore

Nga objektivat kryesore të projektit janë:

1. Zbatimi i kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurive dhe të drejtën e informimit me fokus regjistrimin fillestar të pasurive,
2. Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve për



regjistrimin dhe transaksionet me pasuritë,

3. Identifikimin e mundësive në lidhje me ushtrimin e të drejtave të pronësive nga qytetarët, vecanerisht grata.

Synohet Qëndrueshmëria

URI dhe zyra ZRPP Pogradec do të jenë në kontakt me palët e interesuara, duke iu ofruar atyre informacion dhe përgjigje për pyetjet dhe shqetësimet që lidhen me procesin e regjistrimit të tyre. Si e tillë, kjo fushatë përfshirëse publike që kombinon takime me fokus grupe dhe shërbime të konsultimit do të shërbejë si një rol logjistike në proces dhe do të ndihmojë për të bashkëpunuar me efikasitet me popullsinë lokale për të koordinuar parregullsitë dhe monitorimin e aktiviteteve.

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njerëzit e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

FAKTET KRYESORE

PARTNERËT:

- ✓ Ambasada Holandeze

KOHËZGJATIA:

Nëntor 2013-Maj 2015

PËRFITUESIT:

- ✓ Banorët e Rrethit të Pogradecit

REZULTATET E PRITSHME:

- ✓ 100% e familjeve me prona të përgjithshme do të behen të ndërgjegjshëm për këtë proces dhe do të marrin njohuritë e nevojshme për regjistrimin fillestar,
- ✓ 100% të bizneseve me pronat të përgjithshme do të behen të ndërgjegjshëm për këtë proces dhe do të marrin njohuritë e nevojshme për regjistrimin fillestar,
- ✓ 50 % të familjeve dhe bizneseve do të marrin këshillim ligjor mbi të drejtat dhe procesin e regjistrimit të pasurive
- ✓ 25 % e familjeve dhe bizneseve do të përfitojnë nga regjistrimi fillestar i pasurive.

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti I Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14

Hyrja 11, Ap. 56

Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: zvokopola@uri.org.al

Web: www.uri.org.al